



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 56, datë 30.9.2017

**PËR DHËNIE PËLQIMI NË PARIM PËR DHËNIE ME QIRA SIPËRFAQE E  
LLOJIT PYLL PREJ 39 HA NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE  
GURI I ZI**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 8 pika 2, 9 pika 1/1.2, 27 pika 5, 36, 54 shkronja “e”, 55 pika 4 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimit nr. 1, datë 9.6.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së mjedisit, pyjeve dhe administrimit të ujrave në bashkinë Shkodër, me 35 vota pro,

**V E N D O S I :**

1. Të japë pëlqimin në parim për dhënien me qira për pasurinë si më poshtë, sipas funksionit dhe destinacionit që ka:
  - Ekonomia pyjore Pruevos-Sheldi ngastra 54, nëngastra-a, zona kadastrale 3168 me sipërfaqe 39 ha, njësia administrative Gur i Zi, pasuri në pronësi të bashkisë Shkodër.
2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij, në mbështetje të Udhëzimit nr. 1, datë 9.6.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit pyjor.



3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 30.9.2017

Shpallur në datën 2.10.2017



**Sekretar i këshillit**

**Suel Hadri**

**KRYETAR**

**Xhemal BUSHATI**







REPUBLIKA E SHKODËR  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Pt-15535 14.10.2017

Nr.1027/1 Prot

Shkodër, më 16.10.2017

Lënda: Mbi vendimin nr. 56, datë 30.09.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr 107/2016, dt 2.10.2016 "Për Prefektin", shqyrtoi vendimin nr.56, datë 30.09.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër "Për dhënie pëlqimi të parim për dhënie me qera sipërfaqe<sup>1</sup> e llojit pyll prej 39 ha ndodhur në njësinë administrative Guri i Zi".

Prefekti në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.2, nenit 27, pika 5, nenit 36, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4 e Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; neni 56 KPA, Ligjit nr.115/2014, datë 31.07.2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 për "Pronat e paluajtshme të shtetit" (i ndryshuar); Ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për Pyjet dhe shërbimin pyjor" (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për Transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-komunave/bashkive"; Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik", miraton VKB me anë të të cilit këshilli bashkiak ka miratuar që është dakort për dhënie në përdorim të sipërfaqes prej 39 ha (dhe jo 6.64 ha)-ekonomi pyjore-Pruemos-Sheldi, ngastra 54, nënngastra a, ZK 3168, NJAD Guri i Zi sipas funksionit dhe destinacionit që ka, për dy qëllime, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj) dhe për ndërtim rezervuarësh për zhvillimin e akuakulturës. (Objekti është i përgjithshëm dhe jo specifik)

Është pikërisht shtruktura e pyjeve në bashki që duhet të ndjekë procedurat ligjore të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik", procedurë e cila mbase kërkon sipas vlerësimit tuaj edhe zbatimin e VKM Nr.1353/2008 "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të procedurave të zvogëlimit të

<sup>1</sup>Terminologjia dhënie pëlqimi në parim për dhënie me qera të vendit të ligjor nr.56, gërmu e të Ligjit nr.139/2015, në këtë dispozitë vrohet këshilli bashkiak (procuri) mirator i jetësimin ose dhe unë për dhënie për dhënie të ligjor.

sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor' apo nëse kemi të bëjmë me zbatimin e dispozitës 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 'Për Fyjet dhe shërbimin pyjor' i ndryshuar.

Tregoni vëmendje pasi sipas pikës 5 të Udhëzimit Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016, për veprimtaritë pushimi struktura përgjegjëse në bashki përgatit një studim për t'u miratuar nga kryetari i bashkisë për një periudhë sezonale jo më shumë se 3 deri në 4 muaj, apo ndërtimi i një rezervuar për zhvillim të akuakulturës i cili është 1.28 ha kërkon zbatimin e një tjetër procedure.

Me respekt

P R E F E K T I

Paulin SHKOCANI

